

KONGRESI IX - TË EUROSAT

Hagë 16 – 19 Qershor 2014

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Të Aprovuara nga Kongresi i Eurosai-t

Parathënie

Kongresi i IX-të i EUROSAT-t, i mbajtur në Hagë, Holandë, më 16 - 19 qershor 2014 pati Inovacionin si temë qendrore të tij.

SAI-t nuk kërkojnë inovacion për inovacion, por inovacion si një mjet i domosdoshëm për të siguruar që vlera e tyre e shtuar të jetë e qëndrueshme në kohë. Pikërisht mbi këtë, ne ndërtojmë vlerat e EUROSAT-t për të ruajtur dhe rritur mirëqeverisjen e ekzekutivit dhe institucioneve të lidhur me të. Në përgatitjen e këtij Kongresi u bazuam edhe mbi të dhëna e Kongresit Young EUROSAT të mbajtur në nëntor 2013.

Në Kongres doli qartë se të gjithë SAI-t janë të përfshirë në një kërkim të vazhdueshëm për të përmirësuar vetveten dhe për të gjetur metodat e punës dhe teknikat e auditimit më të efektshme. SAI-t janë gjithashtu të etur të shkëmbejnë përvojat dhe pikëpamjet e tyre.

Vetë tema e inovacionit i dha Kongresit një formë të pazakontë. Gjatë seancave plenare pati shembuj inovacioni dhe praktikat më të mira u diskutuan në workshop-e dhe seminare, në tregun e IT dhe në seancat me mikrofon të lirë. Më shumë se gjysma e SAI-ve pjesëmarrës organizoi një ose më shumë workshop-e.

Larmia e madhe brenda EUROSAT-t çoi në një shumëllojshmëri të pasur të prezantimeve dhe diskutimeve, gjatë takimeve formale dhe joformale. Roli shumë aktiv i të gjithë SAI-ve rezultoi me ide dhe sugjerime të vlefshme, të gjitha të mbledhura së bashku në një hartë elektronike. Në vitet e ardhshme ne do të përipiqemi të mbrojmë shkëmbimin e ideve dhe të eksplorojmë mundësitë për të përmirësuar punën tonë dhe t'i shërbejmë sa më mirë interesit publik.

Konkluzionet dhe rekomandimet e Kongresit të IX-të të EUROSAT-t kanë si qëllim të ndjekin këtë frymë dhe të ndërtojnë mbi inputet e të gjithë SAI-ve prezent në këtë Kongres. Ato nuk kanë natyrë detyruese, por janë vullnetare. Zbatimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i Planit Strategjik të EUROSAT-t do të rishikohet në këndvështrimin e këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

Ne, anëtarët e Kongresit të IX-të të EUROSAT-t:

Kultura dhe Udhëheqja

Duke konsideruar se:

- konteksti ynë profesional po ndryshon me shpejtësi dhe po bëhet gjithnjë e më ndërkombëtar;
- vlerat të cilat ne i mbrojmë duhet të mbeten të vlefshme;
- prandaj urgjentisht ne kemi nevojë të harmonizojmë mënyrën tonë të funksionimit me ndryshimet përkatëse në shoqëri, të angazhohemi me aktorët tanë kryesorë, duke filluar nga qytetarët tek qeveria.

Duke konsideruar se:

- inovacioni është i nevojshme që SAI-t të përshtaten ndaj sfidave të reja;
- inovacioni ka shumë forma dhe karakteristika
- të gjithë SAI-t kanë përvojë për inovacion;
- inovacioni është një proces që kërkon hapësirë për të mësuar duke vepruar;
- ekziston një tension i perceptuar midis inovacionit dhe një kulture të bazuar në rregulla.

Duke konsideruar se:

- SAI-t duhet të përpiqen të arrijnë një kulturë të të mësuarit dhe të përmirësimit me mundësi për të eksperimentuar;
- SAI-t duhet të sigurojnë rëndësinë e tyre duke qenë të hapur për të bërë gjërat ndryshe, duke bërë gjëra të ndryshme dhe duke trajtuar tema të reja;
- ndarja e eksperiencave dhe dilemave brenda komunitetit të EUROSAT-it është një përfitim i ndërsjellë;
- EUROSAT dhe SAI-t kanë përgjegjësinë të udhëheqin nëpërmjet shembujve.

Rekomandojmë që:

- EUROSAT të kërkojë mënyra për të adresuar tensionin e perceptuar midis inovacionit dhe kulturës së bazuar në rregulla;
- EUROSAT të stimulojë mënyra të qëndrueshme inovative, me kosto të ulët dhe elektronike për të shkëmbyer pikëpamjet, dokumentet dhe përvojat midis SAI-ve;
- EUROSAT të nxisë auditimet bashkëpunuese në tema përkatëse dhe të përkujdeset për eksperimentimin e qasje të reja të auditimit, teknikave dhe produkteve të tij;
- EUROSAT të drejtojë me shembullin e tij në qeverisje dhe mënyrën e të vepruarit;
- EUROSAT të kërkojë një vlerësim të pavarur të qeverisjes dhe mënyrës së veprimit të tij. Bordi Drejtues i EUROSAT-it është i mandatuar për të ndjekur këtë;
- Aktivitetet e ardhshme të EUROSAT-it të bartin frymën e lëvizjes Young EUROSAT.

Shpërndarja e mesazhit

Duke konsideruar se:

- vlera e shtuar e punës së SAI-ve varet në një pjesë të konsiderueshme, por jo ekskluzivisht, nga mënyra se si mesazhi dorëzohet, perceptohet dhe se si veprohet në përputhje me të;
- mesazhi mund të marrë forma të ndryshme dhe të komunikohet në mënyra të ndryshme dhe në momente të ndryshme;
- SAI-t gjithnjë duhet të bashkëveprojnë, në mënyra të ndryshme, me grupet e tyre të interesit, nga qytetarët tek qeveria;
- teknikat e reja të vizualizimit janë duke bërë të zakonshme;
- ka pasur rritje të mëdha në përdorimin e mediave sociale dhe dixhitale.

Konstatojmë se:

- një ndërmarrje e përbashkët mund të ndihmojë përparimin e SAI-ve në aspektin e komunikimit të mesazhit të tyre në mënyrë inovative dhe efektive.

Rekomandojnë që:

- EUROSAT-t të lehtësojë veprimtaritë për të zhvilluar kapacitetin e SAT-ve për "të shpërndarë mesazhin" në një mënyrë efektive.

Të Dhëna të Hapura

Duke konsideruar se:

- SAT-t janë avokatë të përkushtuar të transparencës;
- ka rritje të vazhdueshme në prodhimin e të dhënave të sektorit publik;
- të dhënat e sektorit publik po bëhen gjithnjë e më lehtësisht në dispozicion për të gjithë (të hapura) dhe të arritshme nga çdo vend;
- këto të dhëna po krijojnë mundësi për publikun e gjerë dhe palët e tjera për t'u bërë "auditues në kolltuk";
- teknologjitë e reja po luajnë një rol të fuqishëm në duke kërkuar dhe duke krijuar lidhje midis të dhënave.

Konstatojmë se:

- të dhënat e hapura ofrojnë mundësi të reja për të vlerësuar performancën e qeverisë dhe të rritur transparencën dhe llogaridhënien e sektorit publik;
- të dhënat e hapura sigurojnë se nuk ka më një monopol të pjesës më të madhe të informacionit të qeverisë;
- të dhënat e hapura kërkojnë që SAT-t të mendojnë për rilevancën e tyre, rolin tradicional, mundësitë dhe nevojat.

Rekomandojmë që:

- EUROSAT të lehtësojë diskutimin mbi mundësitë dhe pasojat të dhënat e hapura të SAT-ve, p.sh. cilësinë e këtyre të dhënave.